



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 232, datë 02.05.2024**

**PËR  
KËRKESËN E Z. {...} PËR CAKTIMIN NË POZICIONIN GJYQATAR NË GJYKATËN  
E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 02.05.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe projektvendimin “Për kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin përkatës,

**VËREN**

**I. PROCEDURA E NDJEKUR DHE TË DHËNAT MBI KËRKESËN**

1. Në Këshillin e Lartë Gjyqësor me anë të kërkesës së datës 14.04.2023, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. 2425 prot., datë 18.04.2023, z. {...}, me funksion të fundit gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me status të përfutur të magjistratit, ka shprehur interesin për tu caktuar gjyqtar, në një pozicion në nivel apeli referuar nenit 6, 15, 49/1, 124, 125, 138/1 të Kushtetutës, nenet 1/1, 17/3, 18/3 të ligjit nr.8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 2/gj, 62 dhe 164 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 41, 44, 58/1 dhe 59/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Karta Evropiane e Statusit të Gjyqtarit.

2. Në këtë kërkesë, nga ana e kërkuesit z. {...} theksohet se: omissis... “*Ju parashtoj se pas procedurave përkatëse të kryera nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr.77/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (faqja zyrtare ëëë.parlament.al) jam emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Këtë detyrë e kam filluar më datë 22.12.2020 pas betimit përpara Presidentit të Republikës (ëëë.president.al), sipas parashikimeve të neneve 125/2 dhe 129 të Kushtetutës. Deri përpara emërimit në funksionin e gjyqtarit kushtetues, kryeja detyrën e prokurorit të apelit dhe gëzoja statusin e magjistratit, prej vitit 1997, në kuptim të neneve 1/dh dhe*

164/1 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji për statusin) dhe nenit 18/3 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji GJK). Konkurrimi dhe procedural e përmendura me sipër ndodhen në një moment të pazakontë dhe mjaft sfidues për Gjykatën Kushtetuese, por edhe për jetën institucionale të vendit në përgjithësi, i theksuar nga institucionet kushtetuese apo organizma ndërkombëtarë, përfshirë asokohe qëndrimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Mandati im i gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese përfundoi me datë 09.01.2023, kur u betua përpara Presidentit të Republikës gjyqtarja e re, e emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë Me përfundimin natural të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, pas përmbushjes edhe të detyrimit të nenit 125/7 të Kushtetutës, bazuar në përcaktimet ligjore në fuqi po ju paraqes këtë kërkesë për caktimin tim në një pozicion të nivelit të Gjykatave të Apelit, si në vijim. Pas vendimit të Kuvendit dhe betimit përpara Presidentit të Republikës si anëtar i Gjykatës Kushtetuese, subjekti im fitoi statusin e gjyqtarit, bazuar në përcaktimet e neneve 124 dhe 125 të Kushtetutës, po ashtu edhe parashikimeve të neneve 1/3, 3/1 dhe 4/1 të Kartës Evropiane për Statusin e Gjyqtarit dhe neneve 1/3, 2.1,2.2 dhe 4.1 t137 Memorandumit shpjegues të saj. Fillimi i detyrës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese parashikon marrjen përsipër të gjitha detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të gjyqtarit të cilat u përmbushen plotësisht prej meje, nga njëra anë, si dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe përfitimeve që burojnë nga statusi i gjyqtarit dhe garantohen nga Kushtetuta dhe ligjet e vendit, nga ana tjetër. Referuar kuadrit legjislativ në Shqipëri, por po ashtu edhe të vendeve të tjera ku sundon shteti i së drejtës, çështjet që lidhen me statusin e gjyqtareve konsiderohen me rëndësi themelore jo thjesht si privilegj për këta të fundit, por mbi të gjitha si garanci për ushtrimin në mënyrë të pavarur, me paanësi dhe profesionalizëm të detyrës së tyre. Në mbështetje të sa më sipër edhe Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar nder të tjera se “statusi i gjyqtareve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që çdo palë në një proces gjyqësor i pret në mënyrë legjitime nga gjykata dhe gjyqtari, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave. Karriera është një nga përfitimet që gjyqtaret e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga statusi i gjyqtarit (vendimet nr. 31/2009, 78/2017, 35/2022 të GJK). Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Lartë, kur në vendimet e saj ndër të tjera ka theksuar se ”shtrirja e statusit të gjyqtarit edhe ndaj përfitimeve të tjera, krahas atyre me natyrë ngushtësisht financiare del jo vetëm nga përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës, si dhe nenit 22 të ligjit nr. 96/2016, por është konfirmuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Në disa vendime ajo është shprehur se me termin “përfitime të tjera” duhen kuptuar jo vetëm ato me natyrë financiare, por edhe të drejta të tjera, sikurse mund të jetë p.sh e drejta për karriere e gjyqtarit, të cilat, pasi u jepen këtyre të fundit, nuk mund tu hiqen më, pasi mbrohen nga parimet kushtetuese të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të sigurisë juridike (vendimi 186/12.05.2022 i GJL). Lidhur me sa më sipër dhe bazuar në përcaktimet e neneve 6, 81 dhe 83/1 të Kushtetutës në ligjin e GJK, krahas parashikimeve të tjera, rregullohet edhe statusi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit ashtu edhe pas përfundimit të tij. Kështu në nenin 17/3 të ligjit të GJK, në të njëjtën linjë me parashikimin e nenit 138 të Kushtetutës, përcaktohet se paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit kushtetues nuk

mund të ulen dhe as të preken. Kurse në nenin 18/3 të po atij ligji, i ndryshuar së fundi me ligjin nr. 45/2021. përcaktohet si me poshtë : "Në përfundim të mandatit, me përjashtim të rastit kur shkarkohet nga detyra sipas procedurave të përcaktuara në ligj, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese caktohet në një detyrë tjetër të barabartë ose të përafërt, si dhe përfiton pagesë..... sipas legjislacionit në fuqi. Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve' Sikurse rezulton nga formulimi i saj, kjo dispozite parashikon si garanci karriere për statusin e gjyqtarit kushtetues pas mbarimit të mandatit, caktimin e tij nga organet kompetente shtetërore në një detyrë të barabartë ose të përafërt, çka për gjyqtarët nga radhët e magjistratëve konceptin e përafërsisë konsiderohet se e përmbush e drejta e tyre për t'u caktuar të paktën në një pozicion në nivel apeli, ndërkohë që organet ku kjo e drejtë mund të ushtrohet nga gjyqtari kushtetues, janë gjykatat ose prokuroritë e nivelit të apelit. Ndryshimet e mësipërme në ligjin e GJK janë në harmoni edhe me parashikimet e ligjit për statusin, i cili në nenin 62 të tij përcakton ndër të tjera se : në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si Prokuror i Përgjithshëm ose në raste të tjera, ku ligji parashikon të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, magjistrati ka të drejtë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion". Parashikimi i nenit 62 të ligjit për statusin dhe procedura përkatëse rezulton të jetë aplikuar tanimë, pikërisht kur është disponuar me vendimin nr.266, datë 30.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë që përcaktimi i nenit 18/3 të ligjit GJK, përbën një ndër ato raste që vetë ligji për statusin ka parashikuar se e drejta për caktimin në pozicionin e nivelit të apelit, parashikohet edhe nga ligje të tjera. Nga ana tjetër, nga mënyra e formulimit të nenit 62 të ligjit për statusin, prezumimi ligjor është që subjektet që e gëzojnë atë të drejtë japin garanci të plotë profesionale për të ushtruar detyrën në nivelet e apelit për shkak të funksioneve që kanë kryer në shkallët më të larta të juridiksioneve përkatës, çka rezulton e qartë edhe si qëndrim i ligjvënësit në relacionin shoqëruar të ndryshimeve në nenin 18/3 të ligjit të GJK. Subjekti im i përmbush të gjitha kriteret që parashikohen në ligjin e GJK dhe ligjin për statusin, për t'u caktuar gjyqtar në një nga pozicionet e apelit, për shkaqet e mëposhtme : Së pari, sepse statusi im i fundit është ai i gjyqtarit, të juridiksionit kushtetues. Së dyti, sepse përpara emërimit në funksionin e gjyqtarit kushtetues gëzoja statusin e magjistratit, sipas përcaktimit të neneve 2/gj dhe 164/1 të ligjit për statusin. duke qenë se kam kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar, për të tre komponentët, si subjekt i ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe jam konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 101, datë 23.01.2019, vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 11.03.2019 pasi nuk është ankimuar (ëëë.kpk.al). Ky vendim është rikonfirmuar në mënyrë të përsëritur edhe nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimet nr. 25/2020, 39/2020 dhe 43/2020 (ëëë.gjykataelarte.al), gjatë procedurave të kandidimit tim për në GJK. Së treti, sepse edhe aktualisht i plotësoj të gjitha kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenet 28/a-b-d-dh-e-f dhe 36/3 të ligjit për statusin. Së katërti, sepse në kuptim të nenit 47/4 të ligjit për statusin që lidhet me vjetërsinë, e kam ushtruar funksionin

*e magistratit për me shumë se 23 vjet. Eksperienca e gjyqtarit ne GJK, ku pjesa me e madhe e çështjeve është e lidhur me shqyrtimin e ankimeve kushtetues individualë kundër vendimeve gjyqësore përfundimtare të juridiksioneve civile, penale apo administrative, si dhe vakancat e gjera aktuale në sistemin gjyqësor, janë nder motivet kryesore për të cilat vendosa që të drejtën time për vijimin e karrierës në një pozicion në nivel apeli ta shfrytëzoj tek sistemi i gjykatave dhe jo me tek ai i prokurorisë, që do të ishte alternativa tjetër e të drejtës së përfituar nga statusi i gjyqtarit kushtetues”....omissis.*

3. Nga aktet e administruara në kërkesën e përcjell në rastin konkret jetëshkrimi, rezulton se z. {...} : *omissis ..“nga 01.08.1992 - dhjetor 1997, me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emëruar hetues në Prokurorinë e Rrethit Vlorë. Nga data 24.12.1997, me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga 15.01.1999 - 28.01.2008, zv /Drejtues i Prokurorisë së rrethit gjyqësor Vlorë. Nga tetor 1999 - dhjetor 2000, ushtrues i detyrës së Drejtuesit te Prokurorisë së Rrethit Vlorë. Nga 28.01.2008 - 19.03.2010, Drejtues i Prokurorisë së rrethit gjyqësor Fier. Nga 25.03.2010 - 25.02.2013, Drejtues i Prokurorisë së rrethit gjyqësor Durrës. Nga 28.05.2013 - 28.07.2016, emëruar prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga 17.03.2014 - 12.01.2015, Drejtor i drejtorisë kundër krimit ekonomik, korrupsionit dhe krimit të organizuar, në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga 28.07.2016 - 22.12.2020, transferuar me pëlqim dhe emëruar Drejtues i Prokurorisë së Apelit Vlorë. Nga data 22.12.2020 - 09.01.2023, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.” ...omissis.*

4.Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës hartoi projektvendimin për kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Sa më sipër, në përgatitjen e këtij projektvendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikoi kushtet si dhe edhe kriterin minimal të kërkuar nga ligji për caktim gjyqtari në juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe i paraqitur Këshillit propozimin përkatës.

## **II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS**

5. Mbështetur në dispozitat Kushtetuese si edhe ligjin specifik të zbatueshëm për çështjen në shqyrtim si edhe nga aktet shoqëruese të kërkuesit {...}, Këshilli, vlerëson se kërkimi i tij për tu caktuar në detyrën e gjyqtarit të apelit pas përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është i pabazuar në ligj dhe në prova.

6. Gjatë veprimtarisë së tij ligjore, organi administrativ shpreh vullnetin nëpërmjet akteve administrative individuale, te cilat rregullohen për nga forma dhe procedura e nxjerrjes prej Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Veprimtaria administrative e këtij organi konkretizohet me hartimin dhe nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat janë shfaqje të vullnetit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe kanë për qëllim, krijimin, ndryshimin, apo shuarjen e pasojave të caktuara juridike. Këto akte për nga forma apo përmbajtja e tyre janë akte administrative me karakter të mirëfilltë individual, pasi nxirren në zbatim të një norme të përgjithshme, rregullojnë një çështje të caktuar, i drejtohen një numri të caktuar

subjektsh, të cilët kanë kërkuar shprehjen e vullnetit të saj si dhe evidentojnë qartë karakterin shterues të tyre.

7. Parimet e shtetit të së drejtës të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit” (neni 4 i Kushtetutës) detyron dhe limiton vullnetin e organit administrativ, në rastin “de qua”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në domosdoshmërinë e respektimit të parimeve thelbësore përgjatë procedurës administrative e duke i mundësuar kërkuarit ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara nga dispozitat ligjore.

8. Shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të shprehur vullnetin e tyre në çdo rast kur i kërkohet nga ligji nëpërmjet akteve administrative (neni 16 i Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A), të cilat nuk duhet të përbëjnë “*flatus vocis*” por duhet të përfaqësojnë cilësinë efektive të ushtrimit të aktivitetit administrativ, sjellja e të cilit duhet të jetë legjitime (neni 4 Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A), e drejtë dhe e paanshme (neni 13 Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A), e hapur dhe bashkëpunuese me personat private (neni 10 Ligjit nr.44/2015 K. Pr. A).

9. Aktet juridike që nxirren nga ky organ duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Siç rezultojnë nga arsyetimi i sipërcituar karakteri ligjor i aktit administrativ është një ndër veçoritë kryesore të tij. Sipas këtij elementi të rëndësishëm akti duhet t’i referohet në çdo rast kërkesave të ligjit me qellim që të mos vij në kundërshtim me të dhe të mos kalojë kufijtë e tij. Që akti të jetë i ligjshëm duhet që përmbajtja e tij të jetë e njëjtë me përmbajtjen e vetë ligjit në zbatim të të cilit është nxjerrë. Ligjshmëria e aktit administrativ kërkon detyrimisht nga organi i administratës publike respektimin me përpikëri dhe rigorozitet të elementeve thelbësore, si kompetenca e organit, procedura e ndjekur për nxjerrjen e aktit, respektimi i formës apo i elementeve të detyrueshme të aktit, respektimi i ligjit material, në mënyrë të veçantë gjatë gjithë procedurës administrative Këshilli i ka mundësuar palës në proces, respektimin e të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes. Në vlerësimin e kërkesës, Këshilli ka mbajtur në konsideratë dispozitat kushtetuese të cilat mbrojnë në mënyrë të veçantë zhvillimin e karrierës së gjyqtarit dhe si pjesë e saj. Neni 138 i Kushtetutës përcakton elementet e statusit të gjyqtarit, ku për të garantuar ushtrimin e pavarur të funksionit të tij, ndër të tjera është përcaktuar si pjesë e tij edhe zhvillimi i karrierës. Ngritja e tyre në standarde kushtetuese detyron jo vetëm ligjvënësin por edhe zbatuesin e tij të mos cenojë statusin e gjyqtarëve, të drejtat dhe përfitimet që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe në këtë kontekst edhe karrierën apo si pjesë të saj edhe caktimin e tyre në një pozicion/shërbim me mandat të kohor të caktuar, duke qenë se janë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i palëvizshmërisë nga detyra e gjyqtarit, duke përcaktuar saktësisht momentin e fillimit dhe mbarimit të mandatit të tyre, si dhe elemente të tjera që lidhen me të edhe me përfitimin e të drejtave të parashikuara pas mbarimit të shërbimit të sipërcituar. Natyrisht që këto standarde janë parashikuara për të gjithë kategorinë e

magjistratit por në çdo rast ligji ka ruajtur të qartë individualizimin e të drejtave të magjistratit/gjyqtar nga magjistrati/prokurorë në përputhje me formësimin profesional dhe përkatësinë e fushës ligjore që ata mbulojnë.

9.1 Në këtë konkluzion është arritur pasi janë marrë në vlerësim dispozitat Kushtetuese dhe ato ligjore me qëllim identifikimin e frymës dhe qëllimit të kushtetutëbërësit në lidhje me garancitë në nivel kushtetues të statusit të gjyqtarit i cili ruan ngjashmëri për disa elemente të tij me atë të prokurorit, por se nga pikëpamja e ushtrimit të funksionit ka dallime të dukshme kjo edhe për shkak të fushës të cilën mbulojnë.

10. Për të kuptuar thelbin e këtij ndryshimi është e detyrueshme një analizë e detajuar e elementeve të statusit të gjyqtarit, funksionit dhe karrierës së tij. Neni 138 i Kushtetutës përcakton elementet përbërëse të statusit të gjyqtarit, ku për të garantuar ushtrimin e pavarur të funksionit të tij janë përfshirë elemente të pagës, përfitime të tjera si edhe zhvillimi i karrierës. Ngritja e tyre në standarde kushtetuese detyron ligjvënësin të mos cenojë statusin e gjyqtarëve, të drejtat dhe përfitimet që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë. Ky status më pas u mundëson sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që priten në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Sipas jurisprudencës kushtetuese, ligjvënësi duhet të kujdeset edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që gjyqtarët kanë, pra atë të dhënies së drejtësisë. Drejtësia mund të jetë e besueshme dhe me integritet kur jepet nga gjyqtarë që nuk ngjallin dyshime për sa i takon figurës së tyre (*shih vendimin nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuadër karriera, si pjesë integrale e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës, është në funksion të garantimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i tyre krijon njëkohësisht besimin te publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve.

10.1 Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në elementet e sipërcituar, por edhe në ruajtjen e standardeve ndërkombëtare të cilët pohojnë se kushti i nevojshëm për një gjyqësor të pavarur është që gjyqtarët të kenë **sigurinë e qëndrimit në detyrë, palëvizshmëria e tyre.**

***Parimet bazë të OKB-së parashikojnë që:***

*1. Mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, shpërblimi i përshtatshëm, kushtet e shërbimit, pensionet dhe moshë e pensionimit të tyre duhet të jenë mjaftueshëm të garantuara me ligj.*

*2. Gjyqtarët, pavarësisht nëse janë të emëruar ose të zgjedhur, duhet të kenë qëndrim të garantuar në detyrë deri në një moshë të detyrueshme pensionimi ose deri në skadimin e mandatit të tyre në detyrë, kur kjo ekziston.*

Mandatet e fiksuara të detyrës dhe ruajtja e tyre edhe pas lëvizjes së përkohshëm në detyra të tjera sigurojnë garancinë e pavarësisë së tyre të përcaktuar në nenin 145/1 ku parashikohet se: “Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”.

10.2 Parimi i sigurisë juridike i sipërcituar në mënyrë të veçantë në lidhje me ruajtjen e vendit të punës dhe qëndrueshmërinë e saj mbrohen garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, dhe qëllimi i saj është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë (*shih vendimin nr.11, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10.3 Duke iu kthyer analizës së kërkimit të z. {...} i referohemi legjislacionit që rregullon në mënyrë të posaçëm garancitë staturore të parashikuara për magjistratin, mandati i të cilit ka përfunduar në Gjykatën Kushtetuese.

Në vështrim të nenit 18/3 të ligjit nr.8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcaktohet se:

***Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet:***

*a) të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze ose çmohet se është e domosdoshme. Organet përkatëse, të ngarkuara me ruajtjen e personaliteteve të larta, janë të detyruara t'i përgjigjen çdo kërkesë të bërë në këtë drejtim;*

*b) të përfitojnë leje të pagueshme vjetore 40 ditë. Leja vjetore bëhet gjatë muajit gusht-shtator;*

*c) të përfitojnë falas Fletoren Zyrtare, gazeta dhe revista juridike;*

*ç) të përfitojnë në mënyrë të barabartë po ato të drejta që gëzojnë deputetët, sipas neneve 16 pika 1, 19, 20, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit".*

*Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, **përkatësisht në gjykata ose në prokurori**, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.*

10.4 Në këtë dispozite përcaktohet qartë se magjistrati, gjyqtar apo prokuror, ka të drejtë të caktohet në një pozicion në nivel apeli. Dispozita ligjore ka përfshirë në terminologjinë e saj nocionin “magjistrati”. Në sistemin ligjor civil të vendeve të Evropës kontinentale, të tilla si Franca, Italia dhe Shqipëria, magjistrat është një term i përgjithshëm që përfshin Prokurorët dhe Gjyqtarët. Emri magjistrat buron nga termi i vjetër francez “magjistrat”, i cili rrjedh nga fjala latine magistratus, dhe që buron nga fjala magister (mjeshtër), e përberë nga rrënja magnus (i madh).

11. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ndihmon në mënyrë të posaçëm individualizimin e kategorisë së magjistratit pasi objekti i tij është përcaktimi i statusit të magjistratëve (neni 1), term që sipas nenit 2/gj të tij i referohet gjyqtarit (***me përjashtim të atij të Gjykatës Kushtetuese***), prokurorit dhe kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, përshirë kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme. Ky ligj i referohen **magjistratit profesionist** pa bërë asnjë dallim midis gjyqtarit dhe prokurorit për rrjedhim analiza e tij do të bëhet duke u mbështetur në dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e aktivitetit specifik të tij, në bazë të së cilit konstatohen dallime të posaçme.

11.1 Kërkuesi detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese e ka filluar më datë 22.12.2020 në përputhje me parashikimet në nenit 125/2 dhe 129 të Kushtetutës. Përpara emërimit në këtë funksion ai kryente detyrën e Prokurorit të Apelit duke gëzuar statusin e magjistratit/**Prokuror**, prej vitit 1997.

11.2 Në nenin 148 të Kushtetutës përcaktohet se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. 3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.”*

Nga dispozita e sipërcituar rezulton se Kushtetuta e ka veshur prokurorin me kompetenca për të ushtruar ndjekjen penale, si dhe për të përfaqësuar akuzën në gjyq në emër të shtetit, për të garantuar një sistem të një drejtësie penale funksionale, kundër çdo akti që përbën kërcënim për shtetin e së drejtës dhe rendin kushtetues. Sipas nenit 148/ç të Kushtetutës i cili parashikon se:

*“1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.*

*2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj”, një shtetas shqiptar mund të emërohej prokuror vetëm pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak” .*

Organi kompetent, sipas kësaj norme Kushtetuese për emërimin e prokurorëve, është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

11.3 Ndërkohë nocioni/etimologjia gjyqtar rrjedh nga fjala latine *iudex*, e përberë nga fjala *“ius”*, *“e drejta”*, dhe *“dicere”*,“ flas, shpall”, duke përfaqësuar individin që kryeson procedurat gjyqësore, qoftë i vetëm ose si pjesë e një trupi gjykues. Si deklarues mekanik të ligjit, por duke, **interpretus prudentus**”, interpretuar në mënyrë të kujdesshëm dhe në konformitet me frymën e ligjit dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ata zgjidhin konfliktet nëpërmjet vendimeve përkatëse.

12. Neni 136/ a i Kushtetutës, (Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016) përcakton se *“ 1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit 2. Kriete të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”*.

12.1 Nga analiza e dispozitave respektive rezulton qartë se fusha e aktivitetit të magjistratit, gjyqtar dhe prokuror janë të ndryshme jo vetëm për shkak të formimit/profilizimit, funksionit specifik që ata luajnë në shtetin e së drejtës, por edhe Institucioneve që merren me emërimin dhe shkarkimin e tyre (Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor).

12.2 Me individualizimin e funksionit të tyre rezulton qartë edhe përfitimet që rrjedhin nga garancitë staturore përkatëse për çdo profesion. Referuar analizës gjuhësore dhe logjike të



dispozitës të parashikuar nga neni 18/3 i ligjit 45/2021 ku përcaktohet se “*Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*”, rrjedh se të dy kategoritë që përbëjnë magjistratët mbrohen nga garancitë kushtetuese të lidhur me statusin e tyre duke përfshirë emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra, (pa shkaqe të përligjura, me mos ndjekjen e tyre penalisht), si edhe në rastin konkret kur u mbaron mandati në Gjykatën Kushtetuese gëzojnë të drejtën të caktohen në nivel apeli si gjyqtar apo prokuror në çdo rast nëse gëzojnë kriteret e kërkuara për pozicionin në nivel apeli.

12.3 Sipas nenit 1, pika 2, të ligjit nr.96/2016, shtetasi që fiton statusin e magjistratit sipas ligjit e gëzon atë sapo emërohet në funksion dhe e përfundon me mbarimin e ushtrimit të funksionit, për ndonjë nga shkaqet e parashikuara nga dispozitat ligjore.

13. Më tej në funksion të ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë në ushtrimin e funksionit të magjistratit në mënyrë të veçantë në komponentin e statusit atë të palëvizshmërisë nga pozicioni i vendit të punës së magjistratit në të dyja grupimet, gjyqtar dhe prokuror, ligji ka parashikuar që në rastet kur ata për shkak të zhvillimit të karrierës zgjidhen/emërohen në pozicione të sistemit të drejtësisë, në rastin, *de qua*, në Gjykatën e Kushtetuese, me mandate të kufizuara ata kanë të drejtë që të caktohen në nivel apeli përkatësisht si gjyqtarë e prokurorë. Natyrshëm ligji nuk ka përfshirë në nocionin e magjistratit, gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhim në rastin konkret kërkuesi/prokuror me caktimin në nivel Apeli, mbrohet nga sistemi i garancive statuore për disa funksione të caktuara brenda sistemit të drejtësisë në shërbim të ruajtjes së integritetit të magjistratëve si prokuror, jo vetëm gjatë kohës që ata ushtrojnë atë funksion, por edhe pas përfundimit të tij, detyrës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Ky sistem synon jo vetëm të mbrojë por edhe të mundësojë marrjen e përvojës së mbledhur nga këta magjistratë duke i caktuar ata në pozicione të ndryshme brenda sistemit të drejtësisë, ku kanë mundësi të kontribuojnë sipas përvojës, por edhe në përputhje me statusin e tyre. Kjo zgjidhje shërben si nxitje dhe motivim për magjistratët për të konkurruar për funksionet e caktuara.

13.1 Neni 62 bën pjesë në kreun VII “Mandati i kufizuar”, të pjesës III “Zhvillimi i karrierës së magjistratëve”. Caktimi i magjistratit në një pozicion me mandat të kufizuar ose të përkohshëm sipas ligjit janë procese të cilave i nënshtrohet magjistrati gjatë karrierës. Ky proces shoqërohet edhe me kushte, kritere dhe garanci përkatëse. Për këtë arsye, ato janë parashikuar në një kre më vete, ku përfshijnë disa aspekte, si llojet dhe parimet e caktimit të përkohshëm (neni 59), e drejta e magjistratit për t’u kthyer në pozicionin e mëparshëm (neni 60), pozicionet me mandat të përcaktuar nga ligji (neni 61), e drejta për t’u caktuar në nivel apeli për disa kategori magjistratësh (neni 62), si dhe mbarimi i mandatit të kryetarit (neni 63).

Neni 62 përbëhet nga 3 pika, të cilat përmbledhtazi i kushtohen procedurës që ndjekin Këshillat për caktimin e kategorive specifike të magjistratëve në një pozicion apeli. Kriteret dhe kushte e përcaktuar nga ky nen janë si vijon:

- I. Magjistrati duhet të ketë përfunduar mandatin;
- II. Vendi në apel duhet të jetë shpallur i lirë nga këshilli;
- III. Magjistrati duhet të plotësojë kriteret për atë pozicion;
- IV. Magjistrati ka të drejtë të zgjedhë 2 herë mes vendeve që i ofrohen.

13.2 Në kushtet kur magjistrati në rastin konkret përpara fillimit të detyrës si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ushtronte funksionin e prokurorit, me përfundimin e mandatit ai ka të drejtë të kërkojë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë caktimin si prokuror në nivel apel, nëse plotëson edhe kriteret e kërkuara për këtë pozicion, kusht *sine qua non*. Ky kërkim mbrohet nga garancitë që kjo kategori funksionarësh ish anëtarë të Gjykatës Kushtetuese që kanë ardhur nga radhët e magjistratëve të rifitojnë statusin e magjistratit dhe të vazhdojnë ushtrimin e këtij funksioni edhe pas përfundimit të mandatit të tyre në Gjykatën Kushtetuese.

14. Pra vullneti i ligjvënësit i cili përkon me vullnetin e ligjit<sup>1</sup>, pasqyruar në dispozitat ligjore të ligjit material, Ligji nr. 96/2016, ka konfirmuar se shërbimi pranë Institucioneve të Drejtësisë do të merret edhe si vlerësim për kontributin vullnetar të magjistratit/prokuror pjesë e garancive statuore të zhvillimit të karrierës së tij. Në këtë përfundim arrihet dhe i shërben interpretimi që i bëhet tekstit të shkruar të normës, Ligjit nr.96/2016 si edhe në mënyrë të veçantë nenit 18/3 të ligjit 45/2021, (interpretim gramatikor), kontekstit të saj (interpretim sistematik), synimit të normës (interpretim teologjik), si dhe nga materialet përgatitore të ligjit dhe historia e hartimit të tij (interpretim historik) të përgatitur nga aktoret për tu miratuar në Kuvendin e Shqipërisë gjatë përpilimit të draftit të paketës ligjore të reformës në drejtësi por edhe ndryshimeve të ligjit material që rregullon funksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Fakti i ruajtjes së garancisë statuore pra të emërimit “*përkatesisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*”, siç cituam edhe me lart rrjedh edhe për shkak të kontekstit historik ku kjo dispozitë iu nënshtrua ndryshimit.

14.1 Në vështrim të kontekstit historik të miratimit të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se nevoja për miratimin e këtyre ndryshimeve dhe këtij procesi të jashtëzakonshëm kontrolli e vlerësimi për magjistratët, të dy kategoritë përbërëse të tij, kishte lindur për shkak të korrupsionit endemik të pranuar si nga faktori i brendshëm edhe i jashtëm në sistemin e drejtësisë në vend.

14.1.1 Procesi i rivlerësimit u miratua në frymën dhe synimin për të nxjerrë nga sistemi individë, të cilët, për shkak të nivelit të pabesueshëm në justifikimin e pasurisë, në kontrollin e figurës apo të aftësive profesionale, kishin cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ky proces u konsiderua nga kushtetutbërësi, si i vetmi dhe i justifikueshëm për të mundësuar pastrimin e radhëve të sistemit të drejtësisë por që më pas rezultoi shkaktar i krijimit të vakancave në të gjithë

---

<sup>1</sup> Referuar shkresës përcjellëse nga Kuvendi e cila mban datën 29.09.2023 nr. 2909/1 prot., “Relacion për projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” të ndryshuar” faqja nr. 4 e relacionit.

sistemin gjyqësorë përfshi edhe atë Kushtetues duke ndaluar/ pakësuar edhe kërkesat për emërimë në këtë të fundit.

15. Për të nxitur kërkesa për emërimë në mënyrë të veçantë në Gjykatën Kushtetuese si edhe për tu kujdesur edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që ata kanë, pra dhënies së drejtësisë. Ligjvënësi, fuqizoi garancitë statutore në rastin konkret në nenin 18 paragrafi i tretë i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, duke garantuar caktimin e prokurorit apo gjyqtarit pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Kushtetues përkatësisht në gjyqtar apo prokuror në nivel apeli. Në këtë kuptim anëtari i Gjykatës Kushtetuese pas përfundimit të mandatit të tij, nëse gëzonte më parë statusin e magjistratit ka të drejtën e caktimit të paktën në një pozicion në nivel apeli përkatësisht në gjykatë ose prokurori me kushtin që ai duhet të plotësojë kriteret për këtë pozicion sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Garancia e ofruar nga ligji në këtë rast shoqërohet me plotësimin e kriterëve për pozicionin në nivel apeli që duhet të përmbushë anëtari i Gjykatës Kushtetuese që më parë gëzonte statusin e magjistratit.

15.1 Plotësimin e kriterëve për pozicion në nivel apeli, neni 18 paragrafi i tretë i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” e lidh ngushtësisht me përkatësinë e profilit dhe funksionit që ka ushtruar anëtari i Gjykatës Kushtetuese si magjistrat, përpara emërimit të tij si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Anëtari i Gjykatës Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të tij, nëse më parë gëzonte statusin e magjistratit në profilin gjyqtar, atij i njihet e drejta e caktimit në pozicion në një gjykatë në nivel apeli për shkak të përkatësisë që lidhen me profilin dhe funksionin që ai ka ushtruar përpara se ai të merrte mandatin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

15.2 Referuar nocionit të përkatësisë së pozicionit të mbajtur më parë nga magjistrati dhe kriterëve ligjore që ai duhet të përmbushë për pozicionin në nivel apeli, i njëjti rregull i cituar më lart vlen edhe për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese që më parë gëzonte statusin e magjistratit në profilin prokuror. Anëtari i Gjykatës Kushtetuese që më parë gëzonte statusin e magjistratit në profilin prokuror, pas mbarimit të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese i njihet e drejta e caktimit në pozicion si prokuror në nivel apeli për shkak të përkatësisë së tij të mëparshme që lidhet me profilin dhe funksionin e prokurorit që ai ka ushtruar përpara se të merrte mandatin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

15.3 Kriteret ligjore për një pozicion në nivel apeli në gjykatë ose prokurori lidhen ngushtësisht më nocionin e përkatësisë së magjistratit në ushtrimin e funksioneve të tij ligjore si gjyqtar ose si prokuror. Kështu që referuar rastit në shqyrtim, anëtari i Gjykatës Kushtetuese që më parë gëzonte statusin e magjistratit në profilin prokuror, pas mbarimit të këtij mandatit ka të drejtën të caktohet të paktën në pozicionin e prokurorit në nivel apeli nëse plotëson kriteret për këtë pozicion, për shkak të përkatësisë së tij si prokuror përpara se ai të ushtronte funksionin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

16. Në këtë kuadër, pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, ligji i garanton kërkuesit caktimin e tij si prokuror në nivel apeli. Kjo pasi në nenin 13 dhe 16 të Ligji Nr. 97/2016 “Për

organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: “Prokuroria përbëhet nga:

- a) *Prokuroria e Përgjithshme;*
- b) *Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm;*
- c) *prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm; ...omissis..”*

dhe “Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate apeli të juridiksionit të përgjithshëm ushtrohen nga prokurorët e apelit. Juridiksioni i tyre shtrihet në territorin e juridiksionit të gjykatës përkatëse”

17. Ndërkohë kërkimi i tij për tu caktuar në pozicion si gjyqtar në nivel apeli nuk është në pajtim jo vetëm me garancitë statutore të analizuara më lart, por edhe me përcaktimin e nenit 18 paragrafi i tretë i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i cili ndër të tjera parashikon se “..omissis.. me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

18. Për të gjitha argumentet e përmendura më lart, kërkesa e paraqitur nuk është e mbështetur në ligj dhe si e tillë ajo refuzohet.

### **III. KONKLUZIONE**

19. Referuar dispozitave Kushtetuese, ligjin specifik të zbatueshëm si dhe referuar akteve të depozituara nga ana e kërkuesit z. {...}, Këshilli, çmon se nuk rezulton që kërkuesi të plotësojë kushtet edhe kriteret për tu caktuar gjyqtarë në nivel apeli duke shkaktuar në këtë mënyrë rrëzimin përfundimisht të kërkesës së tij.

### **PËR KËTO ARSYE**

Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 4, 136/a , 147/1/a, 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 dhe 100 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 2/gj, 47/4, dhe 62 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 18/3 të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës datë 14.04.2023 të z. {...}, protokolluar pranë Këshillit me aktin nr.2425 prot., datë 18.04.2023, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

### **V E N D O S I :**

1. Të refuzojë kërkesën z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kërkuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**